



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 82

Prishtinë, më 01.07.2013, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinkovic, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Ganimete Musliu, Vjollca Krasniqi, Rasim Demiri, Danush Ademi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Sanije Berisha-OSCE. Avni Arifi-CDF, Naim Hajdari-EULEX, Besnik Ramadanaj-KDI, Skender Perteshi-QKSS.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli, Zarife Aliu dhe Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur, më 14.06.2013;
3. Shqyrtimi i informatës nga Policia e Kosovës lidhur me suspendimin e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës pas vizitës së zyrtarit serb Z. Aleksander Vulin në Kosovë;
4. Shqyrtimi i kërkesës së Policisë së Kosovës për buxhet shtesë;
5. Të ndryshme;

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 14.06.2013

Goran Marinkovic- Unë nuk e kam materialin në gjuhën serbe as procesverbalin as Informatën nga Policia e Kosovës që është parapa në agjendë, dhe kërkoj që ti kushtohet pak me shumë rëndësi kësaj çështje.

Kryetari i Komisionit- Procesverbali nuk ka mundur të përkthehet për shkak të seancës dhe mbledhja është caktuar më herët. Përkthimi në gjuhë adekuate përveçse është e patolerueshme, është edhe detyrim ligjor, ai kërkoi që këto gjëra në të ardhmen të mos përsëriten. Po ashtu ne kemi kërkuar nga MPB-ja që materialet ti sjellin edhe në gjuhën serbe dhe nuk e di pse nuk na janë përgjigjur, por ata e kanë obligim ligjor që çdo dokument ta sjellin në të dy gjuhët. Nëse ju kërkoni ne mund ta shtyjmë mbledhjen.

Goran Marinkovic- Unë s'do të doja ta pengoj vazhdimin e punës së komisionit, por mendoj që nëse unë s'mund ta kem informatën e duhur s'do të mund të kyçem në pikat e radhës së komisionit, nëse e leme për mbledhjen e radhës kjo çështje është shtyre edhe njëherë dhe pasi që e kemi përkthimin për çdo paqartësi do të kyçem.

Kryetari i Komisionit- E falënderoj z.Marinkovic për mirëkuptimin dhe kërkoj që me një letër tu drejtohem institucioneve që i mbikëqyrin që çdo dokument të na vijë në të dy gjuhët.

Procesverbali i mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 14.06.2013, u miratua pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i informatës nga Policia e Kosovës lidhur me suspendimin e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës pas vizitës së zyrtarit serb Z. Aleksander Vulin në Kosovë;

Kryetari i Komisionit- Sipas Informatës së marrë nga Drejtori i Policisë së Kosovës, lidhur me kërkesën e datës 28.05.2013 për ofrimin e informacioneve për suspendimin e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës nga Njësia Speciale Operative, pas vizitës së zyrtarit serb Aleksandër Vulin në Kosovë me datë 07.01.2013, me kërkesë të Prokurores së Eulex-it Natasha Vikavi si dhe Inspektorit Policor të Kosovës për shkak të zhvillimit të hetimeve kundër zyrtarëve policor të Kosovës, IPK për këtë ka rekomanduar te Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, suspendimin e përkohshëm me pagesë të zyrtarëve policor. Sipas kësaj informate, arsyet e këtij suspendimi janë: ekzistimi i dyshimit për përfshirjen e këtyre zyrtarëve në disa vepra penale, dhe pas konstatimit të Prokurores, duke marrë parasysh pozitën në të cilën janë duke e ushtruar pjesëtarët policor, ekzistojnë gjasa se ata do të ndërhyjnë në hetime nëse nuk suspendohen. Sipas këtij rekomandimi, deri në një vendim tjetër, suspendimi i tyre vazhdon të jetë me pagesë.

Rekomandimi është zbatuar duke marrë parasysh Ligjin për Inspektoratin Policor neni 17, ku përfshinë hetimet penale, paragrafi 12 i cili thotë:” Kur IPK konsideron se është në interes të hetimeve, i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë formën e përgjithshme që mund të përfshijë, por nuk kufizohet në llojet e suspendimit me pagesë apo transferim. Rekomandimi duhet të shoqërohet me një deklaratë e cila përmban llojet e rekomandimit, dhe në bazë të udhëzimit administrativ 06/2012 për shkeljet, masat dhe procedurat disiplinore në Policinë e Kosovës neni 47, paragrafi 1.8 dhe 9”.

Ndërkaq, lidhur me fazën në të cilën gjenden hetimet e zyrtarëve policorë, kjo është në kompetencë të Prokurores së çështjes dhe Inspektoratit Policor pas përfundimit të hetimeve dhe jep rekomandim për Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, thuhet ndër të tjera në këtë informatë.

Megjithëse komisioni nuk ka ndonjë informatë të detajuar rreth kësaj dhe hetimet deri në një vendim përfundimtar rreth këtij suspendimi ende po vazhdojnë, është një arsytim i Inspektoratit Policor rreth kësaj informate.

Rexhep Selimi- Lidhur me kërkesën tonë për informim rreth suspendimit të zyrtarëve të Policisë së Kosovës të koduar sipas rrafshit gazetaresk si përfshirja në “Rastin Vulin”. Mendoj se nuk kemi marrë përgjigjen e duhur, por një përgjigje me një tendencë të shmangies, në këtë rast të përgjegjësisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme sepse përmenden dy institucione tjera si Prokuroria e Eulex-it dhe Inspektorati Policor i Kosovës. Sidoqoftë ne seancën e fundit e kemi dorëzuar një raport që ka të bëjë me Inspektoratin Policor të Kosovës dhe një nga pikat si e gjetur në atë Raport, ka qenë pikërisht ky rast, si një e gjetur jo e mirë në IPK. Përderisa atje është vlerësuar si një e gjetur jo e mirë, natyrisht se edhe këtu nuk kemi se si ta vlerësojmë ndryshe.

Këtu janë të padrejta dy gjëra: vlerësimi paraprak ose paragjykimi i mbështetur në rrethana të caktuara politike kur thotë në paragrafin 3 që: “ekzistimi i dyshimit të arsyeshëm për përfshirjen e këtyre zyrtarëve në disa vepra penale. Bazuar në këtë paragraf, askund nuk duket se mund të ketë vepra penale, aq më pak disa vepra penale të pjesëtarëve të Policisë të Njesisë Speciale Operative me rastin e arrestimeve të truprojave të zyrtarit serb Aleksander Vulin. Unë mendoj që është joreale që pjesëtarët e Njesisë Operative të ngarkohen paraprakisht me këtë gjykim. Gjithashtu, megjithse nuk e paragjykoj fajësinë apo pafajësinë e tyre, por mendoj se nuk do të duhej të paragjykohej fajësia e tyre për shkak se kanë bërë arrestimin e truprojave të “dikujt”, dhe ai “dikushi” është i rëndësishëm për rrethanat në Kosovë. Asnjë zyrtar nuk duhet të jetë më i rëndësishëm apo i parëndësishëm në Kosovë, qoftë ai serb, shqiptar apo kushdo tjetër, sepse duke i’u rritur rëndësia këtij zyrtari atëherë është rritur edhe ngarkesa për këta pjesëtarë. Unë e kundërshtoj punën e Inspektoratit i cili i ka bërë Rekomandim Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për suspendimin e këtyre pjesëtarëve pa bërë asnjë hetim paraprak lidhur me përfshirjen e mundshme të tyre për ndonjë thyerje rregullash apo veprash penale. Vet rekomandimi i ka paragjykuar këta pjesëtarë, se kanë bërë vepër penale. Kjo çështje është politizuar shumë dhe për këtë nuk ka pësuar vetëm personeli por është njollosur edhe Policia e Kosovës, sepse sipas kësaj ngjarje duket se bënë vepra penale gjatë arrestimeve të tyre.

Goran Marinkovic- Unë e kam një pyetje sa i përket asaj që e tha z.Selimi. sepse nuk e di a e kuptova mire. A është bërë hetim për atë çështje, sepse sa e kuptova unë nuk janë bërë hetimet dhe është ngritur padi.

Rexhep Selimi- Une e lexova paragrafin e fundit të këtij raporti dhe mendoj se do të duhej që Inspektorati i Policisë pas përfundimit të hetimeve t'i jep rekomandime Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për masat e marra ndaj tyre, dhe jo siç ka ndodhur vetëm me një kërkesë të EULEX-it pa hetime, Inspektorati i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm suspendimin e tyre. Nëse IPK do të hetonte, do të gjente që këta zyrtar janë të përfshirë apo dyshohen për vepra penale, atëherë IPK jep rekomandime, dhe jo si në këtë rast vetëm me një kërkesë të Prokurores së EULEX-it, e cila është tipike politike. Unë e thash pikërisht siç ka qenë e shkruar këtu, por ndoshta ka qenë problemi te përkthimi.

Kryetari i Komisionit- Në bazë të informatës Prokurorja ka kërkuar vazhdimin e hetimeve. Inspektorati në bazë të Rekomandimit të Prokurores ka bërë suspendimin, sipas arsyetimit të cilin e ka dërguar, se ekzistojnë gjasa të mëdha se do të ndërhyjnë në hetime nëse nuk suspendohen. Kërkesa e Prokurores ndaj Inspektoratit ka qenë që Inspektorati të bëjë kërkesën te Drejtori që t'i suspendoj, që të zhvillohen hetimet, dhe gjykimi se a është bërë mirë apo jo mund të jetë pjesë e diskutimit të mëtejshëm.

Fatmir Xhelili- Duke u bazuar në çështjen procedurale, momentin që është një dyshim i bazuar për një vepër dhe e merr Prokurori, kërkesa e tij është urdhër dhe Inspektorati është i detyruar ta zbatoj. Prej atij momenti Prokurori udhëheq me rastin deri sa të grumbullohen faktet adekuate për prezantimin para Gjykatës së Procedurës Paraprake që gjykatësi të vendos për vazhdimin e hetimeve të mëtutjeshme apo jo. Nuk është vullnet i Inspektoratit inicimi i një çështjeje të tillë, por kërkesa e Prokurorit në këtë rast është urdhër.

Kryetari i Komisionit- Të gjithë e kuptojmë se jemi në një ambient politik ku ndonjëherë përzihen kompetencat, dhe bëhen veprime me motive politike që edhe në këtë rast nuk mund t'i shmangemi një cilësimi të tillë, sepse vet ardhja e një zyrtari siç është Vulin, mënyra dhe sjellja janë çështje që kanë të bëjnë më shumë me motive politike. Megjithatë kërkesë e vazhdueshme e Komisionit do të jetë që Inspektorati i Kosovës të sillet me profesionalizëm, të gjykoj veprimet paanshëm, para kujt do çoftë, sepse qytetarët e Kosovës janë të barabartë para ligjit.

Goran Marinkovic- Ju faleminderit Kryetar , fatkeqësisht kjo çështje ndoshta është politizua, por mendoj se pa menduar ka folur në ato çështje kur ka thënë që kanë qenë fajtor ose jo, na nuk e dimë. Ne veç kemi folur për këtë çështje por më vonë kemi parë që Inspektorati Policor ka suspenduar 11 Policë që kanë bërë shkelje të detyrës. Ne nuk duhet të ndërhyjmë në punën e Gjykatave dhe Gjykata do ta bëjë vendimin e duhur se kush ka qenë fajtor e kush jo. Çoftë ajo Gjykatë e EULEX-it apo vendore mendoj se ata do ta kryejnë punën e tyre.

Kryetari i Komisionit- Në këtë rast në Prokurori dhe në Inspektoratin e Policisë, sa i përket anës profesionale nuk kemi për çfarë dhe nuk do të duhej të ndërhyjmë. Megjithatë edhe rekomandimet që i kemi bërë lidhur me Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për Inspektoratin, ne i kemi bërë vërejtjet tona, andaj konsideroj se duhet ta mbyllim këtë çështje sepse informatën e shqyrtuam. Kërkesë e Komisionit është edhe ndaj Prokurorisë, edhe ndaj Inspektoratit Policor të Kosovës dhe ndaj të gjitha Institucioneve që t'i kryejnë detyrat e tyre me profesionalizëm pa pasur ndërhyrje. Kjo pikë ka qenë vetëm për shqyrtim dhe jo marrjen e ndonjë vendimi. Andaj e konsideroj të mbyllur këtë çështje.

4. Shqyrtimi i kërkesës së Policisë së Kosovës për buxhet shtesë

Kryetari i Komisionit- Kemi marrë një kërkesë nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë në të cilën ceket angazhimi ynë si Komision që t'iu ofrohet buxhet shtesë që do t'i mbulonte shpenzimet kapitale dhe shpenzimet e tjera përcjellëse në bazë të Marrëveshjes e cila ka ndikuar në ndryshimin e gjendjes në Veriun e Kosovës. Megjithatë mendoj që, meqë Komisioni nuk ka qenë pjesë e angazhimit për ndryshimet që kanë mundur të bëhen, çoftë edhe në Ligjin për Policinë e Kosovës, Drejtori i Policisë së Kosovës t'i drejtohet Komisionit për Buxhet dhe Financa, sepse siç tha ai, kur janë bërë ndryshimet të cilat kanë ndikuar me Marrëveshjen, Komisioni nuk është pyetur, dhe nuk ka ndonjë obligim që të angazhohet me buxhetin.

Fatmir Xhelili- Pavarësisht arsytimit, shpesh ndodhë që adresimi i kërkesave të mos jetë i qëlluar në komisionet adekuate. Propozoj që këtë kërkesë ta bartim drejtpërdrejtë të Komisioni për Buxhet dhe Financa pa rikthimin e tij në procedurë në Polici, dhe për këtë le të vendosë Komisioni për Buxhet dhe Financa. Është një fazë e re e zhvillimeve dhe sigurisht është e arsyeshme kërkesa për mjete shtesë të paparapara në buxhet. Andaj propozoj që drejtpërdrejtë këtë kërkesë t'ia bartim Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Anton Quni- Krahas kësaj kërkesë të bërë nga Drejtori i Policisë së Kosovës, duhet ta kemi edhe një Plan të Veprimit për implementimin e Marrëveshjes. Së pari të shqyrtojmë se ky Plan i Veprimit a është në përputhje me Ligjin për Policinë e Kosovës, sepse nga vet kërkesa për koston financiare mund të nënkuptohet se cili është Plani i veprimit, në kërkesë nuk është paraparë që kjo pjesë e Policisë që duhet të integrohet brenda Policisë së Kosovës, në këtë rast Policia e Serbisë, nuk kalon në fazat e rekrutimit, përzgjedhjes, testeve mjekësore, testeve psikofizike, verifikimit, biografisë së tyre, nuk parashihet trajnimi bazik i tyre, ceremonia e gradimit, betimit etj. Gjitha këto veprime kanë një kosto të vet, dhe nëse këto veprime nuk parashihen atëherë nënkuptohet se kjo Polici vetëm do ta bëjë ndërrimin e bexhave, por do të vazhdoj punën me ligjet, urdhrat dhe standardet me të cilat kanë vepruar deri me tani, d.m.th me ligjet e Serbisë, me standardet e Policisë së Serbisë. Kjo kërkesë mund të trajtohet nga Komisioni duke kërkuar që në të ardhmen Komisioni ta ketë planin e veprimit me të gjitha specifikat. Ky plan duhet të studiohet mirë nga ana e Komisionit se a është në përputhje me Ligjin për Policinë e Kosovës dhe ligjet tjera që do të kenë implikime në këtë rast.

Rexhep Selimi- Pa dashur ta kem epitetin e kundërshtimit, mendoj se para se t'ia dërgojmë Komisionit për Buxhet dhe Financa nuk besoj se do të duhej të kalonim pa e

bërë një vlerësim të situatës prej nga dhe vjen kërkesa. Nuk dua të shpreh qëndrime politike, të cilat dihet se janë të kundërta rreth Marrëveshjes me Serbinë, por nuk mendoj se ne do të duhej t'i jepnim vetës të drejtë ta ndajmë një buxhet për diçka që nuk ekziston. Nuk mund të ndajmë buxhet para se ta ndryshojmë Ligjin, sepse nëse ne ndajmë buxhet duke paragjykuar ndryshime të mundshme të Ligjit të cilat mund apo nuk mund të kalojnë, atëherë kjo i bie të jetë ose urdhër, apo zhvillime jonormale të Kuvendit. Poashtu në infrastrukturën tonë ligjore nuk ekziston termi “Veri”, dhe për këtë nuk kemi se çfarë të ndajmë sepse në këtë kërkesë që në fillim thuhet “rreth implikimeve buxhetore të Marrëveshjes për Veri”. Nuk ka marrëveshje për Veri, ka vetëm Marrëveshje për Normalizimin e Marrëdhënieve me Serbinë. Por nëse pranohet se është marrëveshja për Veriun, atëherë ka ndërhyrje të dikujt tjetër, duke shtuar se kjo kërkesë nga ana e Policisë nuk ka ardhur gabimisht në këtë Komision, ata e kanë ditur adresën e Komisionit për Buxhet dhe Financa, por kanë dashur ta involvojnë edhe Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK . Më duhet të ceku se buxheti i Policisë së Kosovës për vitin 2013 është zvogëluar në dëm dy shtyllave kryesore. Në dëm të buxhetit të paraparë për Ministrinë e Punëve të Brendshme për Operacione Speciale, rreth 5-6 milion sa ka qenë buxheti për këtë shtyllë të Operacioneve Speciale të Policisë së Kosovës, ka rënë apo është suspenduar për gjysmë milioni, po ashtu ka pasur zvogëlim drastik të buxhetit në shtyllën e hetimeve. Prandaj nëse është për të kërkuar buxhet shtesë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës do të duhej të kërkonte buxhet shtesë për atë buxhet për të cilën ka nevojë, pra për Shtyllat e Operacioneve Speciale dhe të Hetimeve.

Fatmir Xhelili- Rreth konstatimeve që bëri z. Quni, dihet se si është arritur Marrëveshja dhe si do të bëhet rekrutimi. Policët që do të rekrutohen në Policinë e Kosovës do të punojnë me standardet e Policisë së Kosovës, standarde që do të arrihen përmes edukimeve që i parasheh Rregullorja e Punës së Policisë së Kosovës, përfshirë këtu uniformën e Policisë së Kosovës, zbatimin e ligjeve të Kosovës sepse ata do të jenë Polic të Kosovës. Ndërkaq sa i përket zvogëlimit të buxhetit në Hetuesi dhe shtyllën e Policisë, me krijimin e shtyllave për luftimin e krimeve specifike në Drejtorinë e Hetimeve, ka qenë i nevojshëm një buxhet i konsiderueshëm në automjetet e ‘mbuluara’, shtëpi jashtë stacioneve policore për pajisje tjera specifike për njësi, andaj kjo nuk nënkupton suspendim se janë marrë ato, por është përfunduar blerja e atyre aparaturave, mjeteve dhe veturave dhe nevoja për mjete është më pak evidente sepse është bërë blerja e shumicës së atyre që janë paraparë. Pra nuk është shkurtuar buxheti qëllimisht por janë përmbushur objektivat e parapara për 2-3 vite për ato njësi me standardet e kërkuara. Buxheti vazhdon të jetë i vogël dhe ka nevojë edhe për ngritjen e kualitetit të mjeteve tjera dhe ngritjen e mirëqenës së policëve.

Kryetari i Komisionit- Është e çuditshme se si kjo Ministri në njërën anë shkurton vija buxhetore aty ku është më se e nevojshme, ku duhet të luftohet krimi i organizuar, duke i falur Ministrisë së Ambientit 1 milion euro në seancë Parlamentare si tepriçë e buxhetit, ndërsa në anën tjetër kërkon buxhet nga ne që ti aprovojmë buxhet shtesë. Gjithashtu duhet kujdes në shprehjen e termeve të cilat i referohen Marrëveshjes për Normalizimin e Marrëdhënieve Kosovë-Serbi dhe se Policia e Kosovës është unike në tërë Kosovën dhe duhet të veprojë si e tillë. Mendoj se kërkesa do t'i dërgohet Komisionit për Buxhet

dhe Financa meqë Komisioni për Punë të Brendshme nuk ka qenë pjesë e angazhimit në pjesën ku është përmendur Policia e Kosovës si element i Marrëveshjes, po ashtu komisioni nuk ka pasur mundësi t'i sigurojë buxhet Ministrisë së Punëve të Brendshme në sektorët të cilët të cilët janë të domosdoshëm dhe nuk mund të angazhohet në sigurimin e buxhetit as për sektorët tjerë.

Rexhep Selimi- Nuk jam kundër rritjes së buxhetit për Ministri dhe Polici sepse ka kërkesa të cilat është dashur të vijnë shumë më herët si për objekte të cilat janë djegur gjatë situatave të ndryshme, kompjuterëve të djegur si dhe rimbursimin e gjitha atyre shpenzimeve që ekzistojnë në Policinë e Kosovës. Refuzimin e kësaj kërkesë e bëjë për dy arsye: për shkak se është kërkesë e vogël dhe për shkak se është kërkesë e cila nuk ka të bëjë me ligjet të cilat Komisioni i Mbikëqyr siç është Ligji për Policinë e Kosovës. Mendoj që së pari duhet të kthehet borxhi sepse nuk është dashur t'i ndalen Policisë së Kosovës 6 milion për buxhetin 2013, aq më pak në shtyllën e Hetimeve, kur dihet se çfarë barre dhe përgjegjësie ka Policia për Hetime. Kjo është edhe kërkesë e qytetarëve të këtij vendi që hetimet të jetë shumë më e avancuar dhe të ketë zbardhje të çdo rasti dhe hetime të mirëfillta të cilat do të ndihmonin edhe sektorët e Prokurorisë dhe Gjyqësisë.

5. Të ndryshme

Goran Marinkovic- Në këtë pikë po ashtu kam vërejtje. Mu më ka ardhur një ftesë nga FSK për pjesëmarrje në ceremoninë e diplomimit. Por prapë ftesa me ka ardhur në gjuhën angleze dhe nuk e di se ku e kanë problemin ata, a po u dukem unë që jam anglez apo pse kjo çështje po përsëritet vazhdimisht.

Rexhep Selimi- Nuk e di kur kemi qenë së bashku në vizitë në Forcën e Sigurisë së Kosovës z. Marinkovic, dhe mundësinë e parë që do të kemi vizitë në FSK ju lus që të vini dhe t'ia thoni Ministrit të gjitha vërejtjet që i keni dhe besoj se do të kenë efekt shumë më të madh.

Kryetari i Komisionit- Lidhur me këtë të dy ministrive asaj të Punëve të Brendshme dhe të FSK-së, dhe agjensioneve të cilat i mbikëqyrin do t'ua përgatisim nga një letër që materialet t'i dërgojnë në gjuhët zyrtare.

Gjithashtu ju njoftoj se nesër udhëtoj për Jordani me z. Krasniqi.

Mbledhja përfundoi në orën 11:10

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi